



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 15 NËNTOR 2019, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 11.11.2019 *(neni 44, pika 2, i Rregullores)*

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Projektrezoluta “Shmangia e krizës kushtetuese me synim legjitimitetin e Gjykatës Kushtetuese - detyrë imperative e organeve më të larta të shtetit” *(neni 78 i Kushtetutës dhe nenet 55 e 98 të Rregullores, votim i hapur me shumicë të thjeshtë votash për miratim)*

4. Projektvendimi “Për shtyrjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore” *(nenet 24 dhe 55 të Rregullores, votim i hapur me shumicë të thjeshtë votash për miratim)*

Gramoz Ruçi – Mirëdita, kolegë deputetë!
Të futet media!

Seancën e ditës së sotme e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

A ka ndonjë sugjerim për procesverbalin?
Urdhëroni, zoti Gjuzi!

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Shqipërisë,

Sot vijmë në një seancë jashtë radhe. Akoma nuk e kemi lexuar rezolutën, ndaj do t'i kërkoja Kryetarit të Kuvendit, të nderuarit zotit Gramoz Ruçi, të na krijojë mundësinë (normalisht po ranë dakord edhe palët e tjera, që janë këtu më me shumicë), të paktën 45 minuta që t'i hedhim një sy. Ky është një moment shumë i rëndësishëm që po kalon vendi ynë. Kjo rezolutë i bie që të shkarkojë Presidentin e Republikës.

Zoti Kryetar, në lidhje me këtë procedurë të përshpejtuar, do t'ju lutesha të na i jepnit këto minuta.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Zoti Gjuzi, projektrezolutën e keni pasur të publikuar në faqen e internetit të parlamentit, kështu që shfrytëzoheni kohën, ju dhe të gjithë kolegët deputetë. Nga dje deri sot kanë kaluar 12 orë.

(Deputeti Gjuzi flet nga vendi.)

Kujtim Gjuzi – Zoti Kyetar, ishim në Korçë!

Gramoz Ruçi – Elektronika punon edhe në Korçë, edhe në Kolonjë, edhe në Devoll, edhe në Maliq, edhe në Vithkuq, edhe kudo.

Pra, për procesverbalin nuk ka sugjerime.

Miratohet.

Njoftime.

Këshilli i Ministrave ka depozituar në Kuvend tri projektligje.

Deputeti Ilir Beqaj ka depozituar projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 55/2015 “Për investime strategjike në Republikën e Shqipërisë””.

Listën e titujve e keni të gjithë mbi tavolinat tuaja të punës. Materialet, si gjithnjë, do t'i gjeni në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

Fillojmë me debatin për projektrezolutën “Shmangia e krizës kushtetuese me synim

legjitimitetin e Gjykatës Kushtetuese, detyrë imperative e organeve më të larta të shtetit”.

Baza ligjore e saj është neni 99 i Rregullores. Debati është me kohë të limituar. Sipas përcaktimit paraprak të Konferencës së Kryetarëve, bazuar në nenin 48 të Rregullores, Janë gjithsej 120 minuta, 70 minuta maxhoranca, 50 opozita, 15 minuta Grupi Demokrat, 10 minuta Grupi i Pavarur, 10 minuta Grupi i Partive të Djathhta, 15 minuta deputetët jashtë grupeve parlamentare.

Fillojmë me diskutimet sipas listës.

Fjalën e ka kryetari i grupit të maxhorancës, zoti Balla, për të prezantuar nismën e marrë nga Grupi Parlamentar i PS-së.

Taulant Balla – Të nderuara kolege dhe kolegë,

Të nderuar qytetarë shqiptarë,

Shqipëria ndodhet në mënyrë të padrejtë, për shkak të një akti antikushtetues të Presidentit, përballë një krize që synon të delegjitimojë Gjykatën Kushtetuese. Ne, si një republikë e pastër parlamentare, ne si përfaqësuesit e saj në Kuvend, kemi detyrimin për të gjetur zgjidhje. Për fat të mirë, baballarët e Kushtetutës ishin të bindur për rreziqet që mund të vinin nga një president me pushtet të madh, arsye për të cilën iu atribuon Presidentit të Republikës kompetenca kryesisht honorifike. Ajo që nuk mund të parashikonin, ishte fakti se, edhe pse me kompetenca të tilla, edhe me pushtet thjesht honorifik, sërish e në mënyrë të dukshme ka tentativa për të bllokuar dhe për të nxitur një krizë kushtetuese.

Të nderuar kolegë,

Ky President do të mbahet mend gjatë, për shkak se doli dhe u vetëtregua si kundërshtari më i madh i Gjykatës Kushtetuese. Në thelb, duke simuluar një krizë kushtetuese, në fakt, Presidenti po pengon plotësimin e vakancave në Gjykatën Kushtetuese, e cila domosdoshmërisht duhet ta luajë sa më shpejt rolin e saj kushtetues, si mbrojtëse e demokracisë, e sundimit të ligjit dhe e të drejtave të njeriut.

Megjithatë, ekspertët që kanë punuar me ndryshimet kushtetuese, të cilat u miratuan këtu, në këtë sallë, me plot 140 vota të anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë, kanë parashikuar edhe mekanizmat zhblllokues për situata të tilla. Afati kushtetues tridhjetëditor është vetëm njëri prej mekanizmave zhblllokues. Nëse u referohemi

opinioneve të Komisionit të Venecies, qasja e saj është e qartë: Gjykata Kushtetuese mbetet e një rëndësie të veçantë.

Në një nga opinionet e këtij komisioni, që përsëritet në të gjitha opinionet, të cilat në thelb kanë krizat të ngjashme kushtetuese, përmendim këtu rastin e Polonisë, të Ukrainës apo të Sllovakisë, Komisioni i Venecies këmbëngul se: “Funksionimi i vazhdueshëm i Gjykatës Kushtetuese si arbitri i fundit në çështjet kushtetuese, është parësor për demokracinë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit.”

Gjykata Kushtetuese është çështje me shqetësim të lartë, duke u konsideruar një çështje e rëndësishë së veçantë për një demokraci. Komisioni i Venecies ka sugjeruar edhe mekanizma në funksion të zhblllokimit të një krize të mundshme kushtetuese. Në rastin e Ukrainës, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese e bënë betimin para parlamentit, jo para Presidentit.

Fakti i refuzimit nga parlamenti, i betimit të dy anëtarëve, çoi në një ngërç kushtetues. Komisioni i Venecies sugjeroi një mekanizëm të paracaktuar në lidhje me betimin e tyre. Ukraina zgjodhi atë të betimit të anëtarëve të zgjedhur pranë vetë Gjykatës Kushtetuese. Pra, jo më aty ku ishte parashikuar nga Kushtetuta, para parlamentit, por para vetë Gjykatës Kushtetuese, e cila më pas edhe u jetësua.

Nuk po ndalemi më tej në teknikalitetet e jurisprudencës, që është shumë e pasur në lidhje me këtë këndvështrim, sepse ata që na ndjekin, qytetarët shqiptarë, e kanë të qartë se Presidenti ynë i Republikës po bën ç’është e mundur për të frenuar reformën në drejtësi. Rasti i Gjykatës Kushtetuese është tentativë e radhës, e cila, sigurisht, do të rezultojë e dështuar, sepse kjo reformë nuk është e maxhorancës sonë, por e shumicës së qytetarëve shqiptarë.

Sot dua t’i bëj një apel Presidentit të Republikës:

Është e papranueshme që, në cilësinë e Kryetarit të Shtetit, të përgojojë pa të drejtë drejtues të institucioneve të tjera të vendit. Kushtetuta jonë e ka vendosur në majën e piramidës institucionale. Nuk ndodh asgjëkundi që Presidenti i Republikës të marrë nëpër gojë kryetarin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, edhe pse në rastin në fjalë, për zotin Dvorani, Presidenti i Republikës duhet të jetë i fundit në

këtë vend, që mund të merret me të, sa kohë që zoti Dvorani ka qenë një prej pesë gjyqtarëve të dosjes penale në ngarkim të Ilir Metës, e që në lidhje me atë dosje penale, të paktën zoti Dvorani ka pasur mendim të kundërt me katër anëtarët e tjerë të gjykatës. Kjo duhet të jetë pjesë e kodit etik të çdo personi të dënuar ose të padënuar, kur bëhet fjalë për një çështje gjyqësore në ngarkim të tij.

Është e padrejtë për këdo, por më së shumti për ne që kemi mandate përfaqësuese, ne deputetët, e për më shumë për Presidentin e Republikës, që të përdorë institucionin e presidentit për të atakuar një gjyqtar apo një ish-gjyqtar që ka gjykuar një çështje në ngarkim të tij e që për rastin në fjalë mund të ketë kërkuar edhe burg.

Zonja e zotërinj,

E bëra këtë parantezë për të kaluar në projektrezolutë. Projektrezoluta mban një emërtesë disi të veçantë për një rezolutë të parlamentit të Shqipërisë: Shmangia e krizës kushtetuese. Padyshim, synim është legjitimiteti i Gjykatës Kushtetuese, e cila është dhe duhet të jetë detyra e vetme imperative e çdo institucioni të shtetit, qoftë Presidenti, qoftë parlamenti, si dhe çdo institucion tjetër që buron prej nesh. Sepse jemi republikë parlamentare dhe të gjitha institucionet e tjera zgjidhen prej nesh.

Duke vlerësuar se Gjykata Kushtetuese është një organ kushtetues, i cili ka si mision ruajtjen e kushtetutshmërisë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe garanton zbatimin e parimeve themelore kushtetuese nga të gjitha institucionet e tjera të Kushtetutës sonë, duke vlerësuar se fillimi i funksionimit të Gjykatës Kushtetuese është jetik, ndër të tjera për zbatimin e objektivave kushtetuese të kontrollit dhe balancave midis pushteteve të shtetit dhe garantimit të drejtave themelore të njeriut, duke vlerësuar se ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 në kuadër të reformës në drejtësi, që rivendosën ekuilibrat kushtetues për të garantuar funksionimin e sistemit të drejtësisë sipas parimeve të shtetit të së drejtës dhe në respektim të parimit themelor të kontrollit dhe ekuilibrit reciprok të pushteteve, kanë përcaktuar qartë rregullat për procesin e emërimit dhe të zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke përfshirë kriteret dhe procedurën përkatëse për përzgjedhjen e

kandidaturave në respektimin e pavarësisë, të paanshmërisë dhe parimit të luajalitetit kushtetues.

Vlerësojmë mekanizmin zhblllokues në procesin e emërimit në organin e sistemit të drejtësisë si një nga elementet thelbësore të reformës në drejtësi i orientuar, por edhe i mbështetur në opinionet e Komisionit të Venecias, që kanë përcaktuar rëndësinë dhe nevojën e mekanizmit zhblllokues, me qëllim funksionimin dhe mospengimin e organeve kushtetuese.

Mbështesim fuqimisht zbatimin e reformës në drejtësi si kriter kyç për sundimin e ligjit dhe forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, si edhe për të ardhmen europiane; reformë kjo që vlerësohet me nota shumë pozitive në progresraportet e Komisionit European, ku Shqipëria vlerësohet, në fakt, si një shembull për t'u ndjekur edhe nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, të cilat janë bashkë me ne në rrugën europiane.

Vlerësojmë ecurinë e zbatimit të deritanishëm të reformës në drejtësi e reflektuar në ngritjen dhe funksionimin e organeve të reja qeverisëse të sistemit të drejtësisë si: KED-ja, që përmenda më lart që është institucioni i vetëm, i cili ka autoritetin e përzgjedhjes së kandidatëve, pasi duhet ta themi me gojë plot se: përmes reformës në drejtësi ua kemi hequr të drejtën politikanëve për të zgjedhur siç duan ata, gjyqtarët që duan ata. Pas vitit 2016 nuk mund të jenë më politikanët vendimmarrësit kryesorë për të zgjedhur prokurorët dhe gjyqtarët. Janë këto institucione tërësisht të pavarura, të cilat BE-ja me të drejtë i vlerëson si institucione që kanë bërë punën që duhet deri tani dhe që duhet ta çojnë këtë mision deri në fund, si dhe hapat e ndërmarrë për plotësimin sa më të shpejtë të vendeve në Gjykatën e Lartë për ngritjen e SPAK-ut dhe për të zgjedhur sa më shpejt Prokurorin e ri të Përgjithshëm.

Vlerësojmë punën e deritanishme të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Rezoluta që është propozuar për t'u miratuar, e kemi thënë edhe dje në Konferencën e Kryetarëve është një draft që duhet të pasurohet nga mendimet e të gjithë deputetëve në këtë Kuvend. Ne duhet të respektojmë procedurën e përcaktuar në Kushtetutë për renditjen e kandidatëve sipas meritës profesionale dhe morale në funksion të

plotësimin të vakancave të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.

Ne, pa dyshim, e kemi përshëndetur dhe e mbështesim zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues, dua t'i citoj konkretisht: zotit Besnik Muçi, emëruar me dekretin e Presidentit në datën 18.10.2019, emërimin e zonjës Arta Vorpsi si anëtare e Gjykatës Kushtetuese në datën 8.11.2019, pas përfundimit të afatit brenda të cilit duhej të shprehej Presidenti i Republikës dhe që këtë kompetencë Kushtetuta ia transferoi Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dhe zgjedhjen e zonjës Elsa Toska dhe zonjës Fiona Papajorgji nga Kuvendi si anëtare të Gjykatës Kushtetuese me plot 105 vota të këtij parlamenti në seancën e ditës së hënë.

Zonja dhe zotërinj,

Janë të plota të gjitha argumentet që ne kemi renditur për të qenë të gjithë në të njëjtën linjë me atë që na sanksionon Kushtetuta. Kuvendi i Shqipërisë u informua se Presidenti i Republikës kishte nxjerrë një dekret nr. 11350, datë 13.11.2019 "Për emërimin e zonjës Marsida Xhaferllari si anëtare e Gjykatës Kushtetuese". E konsiderojmë nxjerrjen e këtij akti në kundërshtim të hapur me parashikimet kushtetuese për kompetencat e Presidentit të Republikës, veprim, i cili ka delegitimuar që në fillim, sapo është firmosur, funksionimin e Gjykatës Kushtetuese.

Kushtetuta e përcakton qartë se në vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese emërohen apo zgjidhen gjyqtarët nga Presidenti, nga Kuvendi dhe nga Gjykata e Lartë. Këto organe ushtrojnë në mënyrë krejt të pavarur kompetencën kushtetuese pa asnjë lloj ndërvarësie mes tyre.

Të tria këto organe kufizohen të emërojnë apo të zgjedhin midis tre emrave të kandidatëve të listuar të parët nga KED-ja. Për Kuvendin dhe Presidentin përveç kufizimit të emërimit apo zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues nga kandidatët e listës që sjell Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka edhe një kufizim kohor, qoftë parlamenti, qoftë Presidenti janë të barabartë në këtë kufizim kohor: vetëm 30 ditë.

Mosushtrimi i kompetencës brenda këtij afati nga Presidenti dhe nga Kuvendi sjell emërimin si gjyqtar kushtetues të kandidatit të renditur i pari në listën e miratuar me vendimin e KED-së. KED-ja, sikurse e thashë më lart, në datën 08.10.2019 i kishte dërguar Presidentit të

Republikës vendimet e saj në lidhje me dy vakancat e të krijuara në Gjykatën Kushtetuese, duke vënë në dispozicion dy lista me kandidatë për secilin vend vakant, me qëllim ushtrimin e kompetencës së saj për të emëruar dy gjyqtarë kushtetues. Ka emëruar zotin Besnik Muçi në datën 18.10.2019 dhe me kalimin e afatit prekluziv 30-ditor në datën 07.11.2019 zonja Arta Vorpsi, që është renditur e para në listën e miratuar me vendimin e KED-së, konsiderohet *ex lege*, anëtare e emëruar e Gjykatës Kushtetuese. Është shumë e qartë për të gjithë, për ne dhe për çdo qytetar që lexon shqip Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Me nxjerrjen e dekretit nr.11350, datë 13.11.2019, Presidenti i Republikës, duke emëruar kandidat tjetër jashtë afatit 30-ditor të përcaktuar shprehimisht në Kushtetutën e vendit, ka shkelur jo vetëm afatin prekluziv brenda të cilit duhet të emëronte gjyqtarin kushtetues midis tri kandidaturave të renditura të parat me vendimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, por ka emëruar si gjyqtar një kandidat që është listuar në vendin e katërt, pra që nuk bën pjesë në listën e cituar nga Gjykata Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese ka caktuar: 3. Një nga të tre duhet të zgjedhet brenda 30 ditëve. Vetëm një nga këta të tre. Nuk mund të shkosh as tek i katërti, as tek i pesti, as tek i gjashti dhe as tek 177-i.

Duke emëruar kandidatin e listuar në vend të katërt me vendimin nr. 132, datë 21.09.2019 të KED-së me justifikimin se zgjedhja e dy prej kandidatëve në të njëjtën listë si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese me vendimin e Kuvendit të ditës së hënë, pra në datën 11.11.2019, e rendit kandidatin e zgjedhur si gjyqtar kushtetues nga Presidenti në 3 vendet e para të listës. Ky është një arsyetim që mund ta bëjë vetëm dikush që ka pasur një qëllim paraprak për të shkuar te emri i personit dhe jo te procedura kushtetuese.

KED-ja është organi i vetëm kushtetues që përcakton renditjen e tre të parëve, si kandidatë ndërmjet të cilëve duhet të emërojnë apo të zgjedhë Presidenti ose Kuvendi.

Zonja dhe zotërinj, rezoluta e sotme është një apel për të gjithë anëtarët e Kuvendit për të vijuar misionin që kemi përpara: atë të implementimit të plotë të reformës në drejtësi.

Të gjitha këto argumente që rendita më sipër dhe të tjera që gjenden në këtë

projektrezolutë për të mos i cituar të gjitha, besoj se janë të mjaftueshme që kjo projektrezolutë të marrë mbështetjen e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për ta çuar përpara reformën në drejtësi.

Është propozuar në projektrezolutë që Kuvendi i Shqipërisë t'i bëjë thirrje në radhë të parë Gjykatës Kushtetuese të marrë përgjegjësinë e autoritetit që i nënshtrohet vetëm Kushtetutës për të mos lejuar deligjitimimin institucional me fillimin e veprimtarisë së re pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, por të zbatojë vetëm urdhërimin kushtetues të renditjes së përcaktuar nga vendimi i KED-së, që përcakton zonjën Arta Vorpsi si gjyqtare të emëruar të Gjykatës Kushtetuese.

Kuvendi i Shqipërisë duhet t'u kërkojë Gjykatës Kushtetuese dhe organeve të tjera të zbatojnë me përgjegjësi detyrat pa krijuar asnjë pengesë për fillimin e ushtrimit të detyrës së gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të zonjës Arta Vorpsi, zonjës Elsa Toska dhe zonjës Fiona Papajorgji.

Kuvendi i Shqipërisë duhet t'i kërkojë Presidentit të Republikës të heqë dorë nga çdo lloj tentative dhe akti që bllokoi zbatimin e reformës në drejtësi dhe funksionimin normal të organeve kushtetuese, ku një nga më të rëndësishmit është Gjykata Kushtetuese.

Kuvendi i Shqipërisë në mënyrë të përsëritur i bën thirrje Presidentit të Republikës që të reflektojë duke e rikthyer institucionin e Presidentit të Republikës në kufijtë e kompetencave të njohura nga Kushtetuta dhe të mos ndërmarrë më asnjë veprim tjetër në shkelje flagrante të Kushtetutës.

Kuvendi i Shqipërisë në kuadër të shmangies së çdo tentative për bllokimin e reformës në drejtësi duhet domosdoshmërisht të angazhohet që të rishikojë legjislacionin për të shmangur në të ardhmen krijimin e situatave që pengojnë në mënyrë abuzive funksionimin e organeve kushtetuese të vendit.

Duke ju falënderuar, shpresoj se ky Kuvend sot, me të gjithë deputetët e pranishëm në sallë, do ta mbështesë këtë projektrezolutë.

Shumë faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Balla!

Fillojmë diskutimet.

Fjalën e ka Nimet Musaj. Të përgatitet Zef Shtjefni.

Nimet Musaj – Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar kolegë,

Në fillim të fjalës sime dua sinqerisht t'ju bëj të ditur se ky fjalim dhe kjo seancë në vend të një seance të pazakontë duhej të ishte një fjalim i një seance normale, sepse ky vend nuk ka asnjë mëkat mbi supet e tij, por ka kaq shumë të pazakonta sa që i ngarkon vetes dhe i ofron botës si ky rasti sot. Prodhojmë më shumë të pazakonta sesa normalitet. Kjo po fillon të bëhet e tepërt, se të pazakontat ne i prodhojmë vetë, në vend të një seance për një çështje kaq teknike, sa është e vështirë që edhe 2 juristë t'i bësh bashkë.

Do të kisha dashur që të diskutoja për qarkun e Fierit nga vij unë, për problematikat që ia ka, siç është rasti i lumit të Semanit dhe ai Vjosës për problematikat që kanë. Nëse janë të vërteta, duhet të merren menjëherë masat dhe duhet të bëhet një seancë e jashtëzakonshme. Prandaj po ju risjell në vëmendje se na duhet një seancë e zakonshme, sepse për festat e nëntorit shqiptarët meritojnë një Shqipëri të qetë, të patrazuar nga aventurat dhe problematikat kushtetuese. Na duhet një Shqipëri e zakonshme, pasi jo më larg sesa dje, në Komisionin për Çështjet e Jashtme të Parlamentit European komisioneri i propozuar për zgjerim dhe për fqinjësi shumë të mirë, zoti Valei, i thirrur në dëgjësë për të fituar votën si komisioner dha të kuptoheshin 3 mesazhe shumë të qarta edhe për vendin tonë.

1. Për të personalisht, për anëtarët e komisionit që drejtuan pyetjet dhe për vetë BE-në hapja e negociatave me Shqipërinë dhe me Maqedoninë e Veriut janë të një rëndësie kyçe. Unë nuk e di nëse grupet parlamentare të PE-së do t'i japin besim në seancën parlamentare zotit Valei apo dikujt tjetër, por ajo që kuptova nga qëndrimi i tij ishte se për Europën zgjerimi i Ballkanit Perëndimor, hapja e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut janë objektivi kryesor primar. Nuk kishte kënaqësi më të madhe duke e ndjekur këtë seancë dëgjimore sesa në objektivin e parë të listuar të zotit Valei të dëgjoja për hapjen e menjëhershme, jua theksoj të menjëhershme të negociatave të Shqipërisë dhe të Maqedonisë së Veriut.

2. Sipas zotit Valei, vetë unioni e shikon të ardhmen e tij të lidhur pashmangshmërisht

me ne, fqinjët e tij, me të cilët e lidh edhe deti, edhe toka.

3. Sipas zotit Valei, që nuk gjeti asnjë kundërshtim nga salla, nëse Europa nuk do të merrte përsipër përgjegjësitë e veta për Ballkanin Perëndimor, por ekziston frika se dikush tjetër do t'i marrë këto përgjegjësi.

Zoti Valei, me eksperiencë të madhe në proceset integruese të Hungarisë, vendit të tij, dhe po me aq përvojë në institucionet e Bashkimit European, shprehet se Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë një perspektivë të qartë europiane në optikën e përbashkët të anëtarëve të Bashkimit European, se vendet tona përfaqësojnë një partner strategjik për Bashkimin European mbi bazën e meritës, por për shkak të interesit gjeostrategjik të Bashkimit European në rajonin tonë, vetë Bashkimi European duhet të bënte më shumë për këto dy shtete, Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Zoti Valei la të kuptohej qartë se angazhimi i tij do të ishte i pakursyer që sa më parë, përpara Samitit të Zagrebit, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut të jenë me negociatë të hapura. Ne duhej të ishim sot këtu:

a) për të bindur njëri-tjetrin se reformat e ndërmarra për hir të integritetit do të synonin impaktin direkt në komunitet;

b) për të garantuar që nga reformat e ndërmarra cilësia e jetës së përditshme, progresi i jetës dhe niveli i lirive njerëzore të ishte i siguar;

c) për platformën e përbashkët të veprimit dhe komunikimit, që të synojnë të rritin shpejtësinë e reformave strukturore dhe institucionale me fokus të qartë zhvillimin ekonomik, funksionimin e institucioneve demokratike dhe reformimin e administratës publike;

ç) jo për të rrezikuar që të humbisnim seriozitetin, por për të theksuar bashkërisht që pavarësisht Jo-së së madhe që u dha, ne nuk do ta humbim interesin për t'u bërë pjesë e Bashkimit European.

Për çfarë jemi mbledhur sot këtu? Për asnjë gjë nga sa më sipër, jemi për një çështje të nxehtë, nga ato që rrezikojnë të na djegin. Nuk po i futem fare rezolutës, por po i kthehem kujtesës e për ta mbyllur po ju them një fjalë që e përdora sapo mora mandatin: "Asnjë hap mbrapa për kërkesat e partnerëve tanë ndërkombëtarë,

për reformën në drejtësi, për reformat jetike të vendit tonë”. Me aq sa ju listova më sipër dëshmoja që fati e do që mbase miqtë tanë t’i kemi më të mirë seç jemi vetë.

Të nderuar kolegë,

Agjenda jonë dhe partnerët tanë janë Europa dhe si e tillë nuk duhet bërë asnjë hap prapa për çështje që na rrezikojnë atë. Dje, në seancën e zotit Valei, u dëshmuua dhe u theksua se pika më e fortë e vendit tonë ishte përmbushja e kërkesave të unionit, sidomos në drejtim të reformës në drejtësi dhe të administratës dhe nuk ka se si në drejtim të së parës të bënim sot një hap mbrapa.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Musaj!

Fjalën e ka zoti Zef Shtjefni.

Të përgatitet Lefter Maliqi

Zef Shtjefni - I nderuar zoti Kryetar,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të dashur qytetarë,

Jemi mbledhur sot në këtë seancë të parlamentit për të diskutuar për projektrezolutën për nevojën e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë.

Kuvendi i Shqipërisë e bëri detyrën e tij konform Kushtetutës, duke votuar dy anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, mirëpo mosfunksionimi normal i këtij shteti ka bërë që shqiptarët ta kuptojnë se ku i ka çuar dhe sa larg i ka çuar politika e mbrapshtë 30-vjeçare e këtyre njerëzve që drejtojnë vendin, të cilët nuk e kanë problem të bëjnë lëmsh jo politikën shqiptare, por edhe politikën ndërkombëtare, duke shpikur terma juridikë që nuk ekzistojnë në asnjë vend demokratik sot në botë.

Respektimi i afateve kushtetuese është detyrim për Presidentin dhe për Kuvendin e Shqipërisë që të zbatojnë me përpikëri afatet ligjore. Kuvendi i Shqipërisë ka vepruar në përputhje me ligjin, duke votuar dy anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. Shqiptarët po e kuptojnë mirë se reforma në drejtësi nuk mund të kalojë kaq lehtë dhe pa probleme, sado që të përpiqen dhe të mundohen të gjejnë forma dhe mënyra për ta bllokuar këtë reformë, se kjo reformë do të jetë çlirimi i plotë i Shqipërisë nga kjo mafie në pushtet, e cila është gati të bëjë çdo gjë vetëm për të ruajtur pushtetin dhe pasurinë që ka fituar në këta 30 vjet. Të gjithë krahët e politikës duhet ta kuptojnë mirë se shqiptarët nuk janë më ata që

thoshin dikur, vetëm të varnin xhaketën diku se do ta fitonte kjo apo ajo parti, shqiptarët janë bërë të zgjuar, sepse e kanë kuptuar se ju po luani me jetën e tyre, me fëmijët dhe të ardhmen e tyre. Shqiptarëve nuk ua hedh më askush nga kjo lloj politike që ka prodhuar konflikte civile dhe vazhdojnë të vjellin vrer kundër njëri-tjetrit. Ju që keni dominuar politikën gjithë këta vjet e mbani mend mirë vitin 1990, kur shqiptarët morën rrugët e botës, se po të rrinin këtu, do të hanin njëri-tjetrin, sepse nuk kishin me çfarë të jetonin. Falë qeverisë dhe popullit italian, që strehoi mbi 500 mijë shqiptarë, shqiptarët sot janë integruar me dinjitet në shtetin italian; falë ndihmës dhe mbështetjes së qeverisë dhe të popullit grek, të cilët ndihmuan gjysmë milionë shqiptarë me bukë dhe vende pune, shqiptarët sot janë të integruar në Greqi dhe kanë ndërtuar jetën e tyre.

Ne duhet t’u jemi përjetë mirënjohës popullit italian dhe qeverisë italiane, si dhe popullit grek dhe qeverisë greke, të cilët i integruan shqiptarët me dinjitet dhe ata sot kanë punën dhe biznesin e tyre, kështu që shqiptarët dhe qeveritë e tyre nuk duhet t’ua harrojnë kurrë këtyre vendeve! Kemi qenë për mbijetesë dhe shqiptarët ia kanë dalë.

Që kur mora mandatin e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë njoha plotësisht zgjedhjet e 30 qershorit si legjitime, votova ligjet e paketës në drejtësi, ndryshimet në Kodin Penal, shkarkimin e Presidentit, pasi ishte në shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit, dy anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe me të drejtën që më jep ligji jam pro projektrezolutës. Shqipëria është republikë parlamentare, ndaj u bëj thirrje Gjykatës Kushtetuese dhe organeve publike, që ngarkohen nga ligji me detyrën në kuadër të Gjykatës Kushtetuese, të zbatojnë me përgjegjshmërinë dhe përgjegjësitë e tyre...

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Lefter Maliqi.

Lefter Maliqi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar shqiptarë,

Jeni duke ndjekur shoun e radhës së tepsisë së majme të Rilindjes. Deputetë të maxhorancës, të cilët edhe populli nuk i kupton, flasin serbisht dhe rusisht, duke mos folur gjuhën e tyre.

Pra, këta flasin në emër të popullit, ndërkohë që nuk janë deputetët tuaj, këta janë deputetë të lartmadhërisë, deputetë të kryetarëve,

deputetë që mezi lexojnë, deputetë që, edhe kur ua përgatisin të tjerët fjalën, nuk dinë ta lexojnë, deputetë me të shkuar kriminale, disa, 4-5 prej tyre, edhe bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit, prandaj nuk shkojnë të bëjnë verifikimin. I gjithë ky shou sot është për t'i marrë kompetencat Presidentit të Republikës si i vetmi institucion, të cilin nuk po e kapin dot këta. Ndërkohë edhe në ligj, edhe në Kushtetutë thuhet që 3 anëtarë të Gjykatës Kushtetuese i zgjedh Presidenti, 3 parlamenti dhe 3 Gjykata e Lartë. Këta duan t'ia marrin, sepse kanë frikë nga zgjedhjet drejtpërdrejt në popull, kanë frikë nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese për të anuluar zgjedhjet false të 30 qershorit, të cilat populli i bojkotoi, ku demokracia lokale tashmë është e përdhunuar dhe këta po e çojnë vendin në diktaturë.

Lartmadhëria mund të gënjejë një njeri, mund të gënjejë disa, mund të gënjejë edhe popullin për një kohë, por kurrë për gjithë jetën. Kjo është më se e vërtetë. Gjatë gjithë kësaj kohe kemi vetëm mashtrime. Edhe Enveri po të ngrihet, u tha, nuk do t'iu prishen shtëpitë. U tha se do të ketë legalizime falas, por çfarë ndodhi? Ua prishi.

Ky po lodh studentët, po lodh banorët e Astirit, po lodh edhe këta të Teatrit, se teatrin ka për ta prishur, ky me helmin e vet lodhi edhe opozitën.

Unë u bëj thirrje të gjithëve: studentëve, opozitarëve, socialistëve të ndershëm, të ngrihen në këmbë, të mos kenë frikë as nga helmi i Lleshajt, që e ka kthyer policinë në ushtri, që u bën presionin psikologjik me vetingun policëve me 400 mijë lekë rrogë, ndërkohë këta që janë të korruptuar, që vjedhin paratë tuaja nuk kalojnë në veting. Nuk po kalojnë në veting as punonjësit e doganave dhe tatimeve, por po kalojnë në veting policin me 400 mijë lekë. Ky është një turp. Ky është një skandal. E kanabizuan dhe e kriminalizuan vendin, e poshtëruan, i morën të gjitha institucionet. Ku po shkojmë? Po luftojnë Presidentin, ndërkohë që në vitin 2013 me ngjalla e me verë e me çdo gjë iu lutën dhe ai u dha pushtetin, u dha tepsinë, por nuk ishin të kënaqur.

Bënë marrëveshje në vitin 2017 me Bashën për t'ua futur forcave të tjera politike, siç gënjyen dhe mashtruan Shpëtim Idrizin, që ia morën edhe mandatin në Tiranë, sepse këta donin tepsinë e babëzinë vetëm. Këta po vjedhin

dhe ju si parlamentarë dhe deputetë të rinj, nëse jeni me këta, rrini këtu. Janë disa të ndershëm këtu, por disa nga ju po i shërbejnë këtij, sepse janë të joshur e të manipuluar. Kjo është përgjegjësia juaj, por, nëse ju nuk jeni, largohuni, sepse po ia jep edhe Gjykatën Kushtetuese kësaj maxhorance. Këta nuk pyesin, këta thonë se nuk pyesin as për dekret, as për vendime, as për Kushtetutë, as për ligj e as për Maliq, jo për mua. Këta janë të pafryrë. Unë jam për Unazën e Re, po dëmshpërblimi i banorëve? Më parë për dy metro që i merrej një banori, dëmshpërblehej. Babëzia e tyre është shumë e madhe. U bëj thirrje të gjithëve të bëjnë një revolucion demokratik për të mposhtur diktaturën që këta po instalojnë!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Fjala për zotin Valteri. Të përgatitet Enver Roshi.

Halit Valteri – Faleminderit!

I nderuar drejtues i seancës,

Të nderuar kolegë,

Me keqardhje po shoh se maxhoranca e paska humbur kujtesën e saj, sepse ose janë prekur nga amnezia, ose po tallen me shqiptarët, të cilët nuk po dinë kë të dëgjojnë më parë për Presidentin Ilir Meta. Një herë iu del Kryeministri dhe thotë president më të mirë nuk ka pasur Shqipëria, madje edhe po ta pyesni sot, nuk ka për ta mohuar. Për këtë shqiptarët shqyejnë sytë, sepse iu kujtohet Rama kur mori mandatin në vitin 2013 me premtimin se do të bënte drejtësi, pastaj 4 vjet më pas iu tha se ai që doli cullak në video qenka më i miri. Po më i miri i kujt? Më i miri i të këqijve, se 21 janarin për Ilir Metën e keni bërë, nuk e keni bërë as për mua dhe as për këta njerëzit këtu. Patjetër që nuk i heq asnjë presje, se, nëse ai është më i miri i të këqijve, mjerë shqiptarët nga kush po qeverisen. Pak më parë na doli në foltore kryetari i grupit parlamentar socialist, i cili mendon komplet tjetër nga Kryeministri për Presidentin, sipas tij Presidenti është shkelës teknik i Kushtetutës. Pra, Presidenti më i mirë që paska vendi ynë, që ju e votuat me duartrokitje dhe me dajre e daulle na qenka shkelësi kronik i Kushtetutës. Faj i kujt është ky? Është faj i opozitës, apo i shqiptarëve?

Një pyetje kam për ju, zoti Balla, po më i keqi prej jush çfarë mund të bëjë tjetër? A keni gjë tjetër në dorë që mund të bëni? Keni tre muaj që luani kukafshehtas për Presidentin e

Republikës, dhe nuk keni guxim as të mblidhni komisionin hetimor? Po çfarë ka mbetur më për të bërë në atë komision hetimor? Shoku Ulsi nuk qenka këtu. Shkarkojeni Presidentin, apo është pjesë e lojës suaj? Ju jeni të gjithë bashkë, Rama, Basha, Meta, jeni të gjithë bashkë dhe ndani paratë e shqiptarëve. Dikujt i jepni vila, dikujt tenderë, me dikë tjetër ndani të gjitha paratë që keni vjedhur 30 vjet. Pse bëni këto lojëra? Jeni të gjithë bashkë. Jo rezoluta të bëni ju, po raketa të shpikni, jeni të gjithë hajdutë që e keni përçarë dhe e keni shkatërruar këtë vend.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Fjala për Enver Roshin. Të përgatitet Andi Përmeti.

Enver Roshi - I nderuar zoti Kryetar,
Të nderuar kolegë,

Kur në muajin mars ne vendosëm të futemi në parlament, hymë me një mision, i cili është misioni i shqiptarit, misioni i atdhetarit dhe misioni i politikanit për ta futur Shqipërinë në Europë. Ky është misioni ynë, të votojmë reformën në drejtësi, të gjitha ligjet, që ky popull i shumëpërvuajtur dhe hallexhi të hyjë në Europë dinjitoz, të mos kontrollohen vizat natë e ditë, por të shkojnë e të vijnë, siç i takon një kombi të vjetër.

Tashmë u mbushën tre vjet e gjysmë. Në historinë botërore njihen ngjarje madhore që jo për 3 vjet e gjysmë, por për një vit janë krijuar sisteme, janë përmbysur sisteme, janë ndërtuar shoqëri, janë emancipuar kombe. Por tre vjet e gjysmë për të përfunduar një reformë të tillë në drejtësi është shumë e gjatë, është shumë e lodhshme, njerëzit kanë humbur durimin dhe presin kur do të fillojë punën Gjykata Kushtuese, kur do të krijohet SPAK-u, kur do të krijohet Byroja e Hetimit e gjëra të tjerë.

Kjo është ajo për të cilën ne ndiejmë dhimbjen tonë intelektuale, por edhe në emër të njerëzve që na presin jashtë, për të shikuar...

Nga kjo foltore bëjmë edhe një herë thirrje, që për të gjitha këto ngërçe, për këto artifica të krijuara me qëllim apo pa qëllim, t'i thërrasim këta dhjetëra mendimtarë të vyer që kemi jashtë këtij parlamenti dhe të na këshillojnë se si këto ngërçe të krijuara në mënyrë artificiale të kalohen pa qenë nevoja të bëjmë rezoluta, dhe sot, së bashku, ndoshta të festonim, të bënim ceremoninë e krijimit të Gjykatës Kushtetuese në mënyrë dinjitoze.

Duke qenë një komb i vjetër, edhe neve këtu në parlament nuk na takon të prodhojmë ngërçe artificiale, shpeshherë të shëmtuara dhe për më tepër një ulje të imazhit tonë jashtë vendit.

Unë, jo vetëm si deputet, por edhe si intelektual, i bëj thirrje gjithë parlamentit, sepse ne jemi ligjbërësit, ne jemi maja, që të prodhojë të gjitha ato që duhen për ta çuar vendin aty ku duhet, për t'i dhënë këtij populli shpresën e duhur, mirëqenien...

Ky popull ka shumë halle e problematika. Ne merremi me gjëra të tjera, kur vuajtjet janë të tjera. Jemi larguar shumë nga problematika sociale e njerëzve, duke humbur kohë nëpër reforma e të tjera.

Unë them që sa më shpejt të bëhet i mundur krijimi i Gjykatës Kushtetuese.

Mendoj se kjo rezolutë është një thirrje, që ta dëgjojë edhe Europa, edhe Amerika, edhe ata që na duan, se ne e duam Europën dhe duam të shkojmë atje. Ata na duan atje, por nëse duam të shkojmë atje, këtë duhet ta bëjmë me institucione.

Kjo ishte ajo që doja të thosha.

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr zonja Hysi.)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Roshi!

Fjalën e ka deputeti Andi Përmeti. Të përgatitet deputeti Korab Lita.

Andi Përmeti – Të nderuar kolegë,

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

A ta alternoj një herë unë radhën?

Sot të gjitha palët duhet të ndihen të turpëruara para shqiptarëve.

Sot ne mund të jemi i vetmi vend në botë që e trajton Kushtetutën në mënyrën më barbare të mundshme.

Mund të jemi i vetmi vend në botë, ku gjithsecili, që nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë e deri tek anëtari me i fundit i një partie, që nuk ka mbaruar kurrë një shkollë të lartë, ka një interpretim personal për Kushtetutën, sipas interesave, orekseve dhe dëshirave të momentit. Kjo, për fat të keq, na ka sjellë sot në një bllokim të ri kushtetues.

Ne mund të jemi i vetmi vend në botë që ka dy anëtare të Gjykatës Kushtetuese për një pozicion, dy zonja që duhet të ulen në një karrige, të punojnë në një kompjuter dhe të marrin një rrogë, sepse dy kryetarët e “kçk”-ve

më të mëdha historike në Shqipëri që prej vitit 2000 e deri sot luftojnë për territore, luftojnë për të kapur Gjykatën Kushtetuese, luftojnë për të kapur drejtësinë.

Shqiptarët sot janë dhe duhet të jenë të zhgënjyer, jo prej këtyre dy kryetarëve të “kçk”-ve, që kanë kapur gjithçka në këta 20 vjet, dhe kur them kanë kapur gjithçka, nuk e kam fjalën për të mira materiale dhe monetare, por se i kanë marrë shpirtin këtij vendi, u kanë vjedhur shqiptarëve të ardhmen e fëmijëve.

Shqiptarët sot nuk janë të zhgënjyer nga këta, se, në fund të fundit, nuk ka shqiptarë normalë, përveç atyre të PPP-ve dhe atyre me të cilët luan kalçeto Ilir Meta në plazh, që të ketë shpresë se këta mund të bëjnë ndonjë gjë të mirë për këtë vend, por janë të zhgënjyer me dy zonjat candidate për në Gjykatën Kushtetuese, me zonjën Vorpsi dhe zonjën Xhaferllari.

Zonja Vorpsi vetëm para dy ditësh deklaroi se do ta linte ta zgjidhnin institucionet këtë ngërç të ri juridik, ndërsa dje me vrap vajti te noteri, ku noterizoi citimin e saj në Gjykatën Kushtetuese, duke u treguar shqiptarëve se për të më i rëndësishëm ishte vendi i punës sesa mbrojtja e Kushtetutës.

Të njëjtën gjë bëri edhe zonja Xhaferllari. Ajo e dinte shumë mirë që nuk mund të zgjidhej e katërta në një listë që ka vetëm tre kandidime. Ajo e dinte shumë mirë që nuk mund të zgjidhej jashtë afatit 30-ditor që parashikon ligji organik për Gjykatën Kushtetuese, megjithatë dje vajti e u betua me buzëqeshje te Presidenti i Republikës së Shqipërisë, duke u treguar shqiptarëve që për të ishte më i rëndësishëm vendi i punës sesa mbrojtja e ligjit.

Sot shqiptarët janë të zhgënjyer, sepse e kuptojnë që këtu ka dy kryetarë “kçk”-ësh, që duan përsëri të kapin gjithçka dhe ta mbajnë këtë vend peng edhe për 30 vjet.

Prandaj, ka ardhur koha që të gjithë të luftojnë për t'i larguar këta të dy. Sigurisht, duhet të kenë vetëm pak fare durim: SPAK-u është te dera dhe nuk do të ketë person, që e ka kapur këtë vend dhe i ka marrë atij shpirtin, nuk dotë ketë prangat në duar mbas SPAK-ut. Ky dhe vetëm ky do të jetë sukcesi i reformës në drejtësi. Çdo gjë tjetër do të jetë një mjerim edhe për 20 vjetet e ardhshëm për këtë vend.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Përmeti!

Fjalën e ka deputeti Korab Lita. Të përgatitet deputeti Kostaq Papa.

Korab Lita – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar...

Vasilika Hysi – Ju kërkoj ndjesë!

Zoti Karamelo, ju lutem, lexojeni Rregulloren! Nuk ka më diskutantë nga grupi i shumicës, përveç fjalës së Kryeministrit. Sipas Rregullores ka një shpërndarje proporcionale midis grupeve parlamentare, në varësi të numrit të diskutantëve të regjistruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Alternim po, por ka më shumë deputetë jashtë grupeve parlamentare që kanë kërkuar fjalën.

Korab Lita- Të nderuar qytetarë,

Sot jemi njoftuar për një seancë të jashtëzakonshme, për të reaguuar me rezolutë ndaj dekretit të Presidentit të Republikës..

Të nderuar kolegë, tashmë në sytë e qytetarëve seanca e sotme e parlamentit, por edhe plot seanca të tjera, ngjasojnë me atë shprehjen popullore, “Hajduti thotë kapeni hajdutin”.

Ne të gjithë jemi dëshmitarë që këto situata, sidomos vitin e fundit, kanë qenë të shpeshta. Pse ndodh kjo?

Si u katandis Republika jonë në këtë derexhe, ku shumica e institucioneve të shtetit ose janë jofunksionale, ose janë në kufijtë e mosfeksionimit?

E ç'mund të presësh tjetër nga kjo klasë politike, e cila prej 30 vjetësh po e tërheq zvarrë Shqipërinë?!

Ç'mund të presësh tjetër nga kjo klasë politike, kur sa herë e sheh veten të rrezikuar bëhet bashkë dhe i sulet Kushtetutën për ndryshimet e rastit, apo për ndryshimet e nevojshme sipas qejfit?!

Kjo ndodhi edhe në muajin prill të vitit 2008. Për shkak se klasa politike kishte hyrë në krizë, Kushtetuta u ndryshua brenda një nate. Kjo është zanafilla e gjithë kësaj që po përjetojmë sot. Nga kjo kohë filloi rrëzimi i institucioneve. Fillimisht u kap dhe u zhvlerësua roli i deputetit në parlament, çka ishte shumë e rëndësishme. Po ashtu, u privatizuan partitë politike, nga parti kolegjiale, u bënë parti të unit, të njëshit, pra të kryetarëve. Pas kësaj filloi rrënimi i institucioneve të shtetit. Qytetarët e

dinë mirë dhe presin që rrënimin e shtetit ta ndalojë dhe ta ndërtojë reforma në drejtësi. Të gjithë qytetarët e dinë se klasa politike aktuale ka qenë gjithmonë kundër reformës në drejtësi, pasi, e para që rrezikohet nga kjo reformë, është po kjo klasë politike.

Të gjithë jemi dëshmitarë që seanca e miratimit të reformës në drejtësi erdhi pas një maratone të gjatë takimesh, shmangiesh, deri edhe kërcënimesh nga institucionet ndërkombëtare, kryesisht nga Ambasada Amerikane ndaj politikanëve që nuk donin të shkonin në atë seancë. Pa pikën e turpit, kur u votua në atë seancë, të gjithë u ngritën në këmbë dhe duartrokitën, ndërkohë gjysma e tyre u detyruan të shkonin në atë seancë. Pas këtij momenti filloi kalvari i gjatë i goditjes nga të gjitha krahët e politikës. Kjo goditje, kjo zvarritje na ka sjellë sot në këtë seancë. Kanë kaluar 5 vjet dhe ju siguroj që edhe viti i gjashtë do të vazhdojë me sabotimin e reformës.

Durimit të shqiptarëve tashmë po i vjen fundi. Mekanizmat ekstraligjore të Presidentit apo të parlamentit janë baltosje dhe sabotime të reformës, ndaj, në emër të qytetarëve dhe të deputetëve të opozitës, ju bëj thirrje: mjaft me këto metoda të dala boje!

Pas shkatërrimit të institucioneve, pas shkatërrimit institucional, që i keni bërë shtetit, thirrini mendjes para se t'ju vijë fundi. Bëni një herë të vetme diçka për Shqipërisë, pasi me ligj e shkatërruat funksionimin e partive politike, me ligj i shkatërruat zgjedhjet dhe zhvlerësuar botën e shqiptarëve, shkatërruat Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë, si dhe çdo institucion tjetër të drejtësisë. Presidenti, i pari, po kontribuon në bllokimin e formimit të institucioneve. Askush nuk është mbi ligjin, qoftë edhe Presidenti i Republikës. Unë ju bëj thirrje t'i thërrisni mendjes dhe ndërgjegjes, nëse ju ka ngelur sadopak!

Në këto momente u bëj thirrje institucioneve ndërkombëtare dhe në veçanti aleatëve amerikanë të monitorojnë me kujdes procesin e formimit të institucioneve. Nëse nuk do të kishin frikë prej tyre, këta do ta shkatërronin reformën në mënyrë totale. Këta e duan Shqipërinë pa institucione.

E vetmja strukturë parlamentare, që sot realisht është për formimin e institucioneve kushtetuese, janë deputetët e opozitës të futur

rishtas në Kuvend, pasi ky është edhe qëllimi i futjes së tyre në parlament.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Lita!

Fjalën e ka deputeti Kostaq Papa.

Të përgatitet deputetja Elda Hoti.

Kostaq Papa – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Motra dhe vëllezër shqiptarë,

Përpjekja për të ngritur tensione politike është e shtirë nga të dyja palët, nga të gjitha palët dhe nuk i jep vlera politikës dhe as situatës, por përpiqet të gatuajë një çorbë, një vorbull apo një turbulencë politike, të provuar e të ngjashme me ngjarjet e periudhës, pas datës kur zoti President “zhdekretoi” zgjedhjet e 30 qershorit. Kjo situatë paraqitet e ngjashme me atë periudhë dhe me të njëjtën përjasje vjen edhe përpjekja për të turbulluar situatën dhe për të krijuar një tjetër ngërç.

Institucionet ndërkombëtare, aleatët tanë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe BE-ja bëjnë thirrje të ngrihet sa më shpejt Gjykata Kushtetuese, për të mos krijuar një ngërç të ri dhe për të mbyllur përfundimisht periudhën e mungesës së kësaj gjykate, kur si pasojë vendi u përfshi nga konflikte institucionesh të pazgjidhshme dhe të painterpretueshme.

Përpjekja për të krijuar ngërç nuk ka sens pozitiv dhe duhet goditur politikisht. Kjo përpjekje përpiqet të fshehë të vërtetën ose të zvarritë proceset e reformës në drejtësi, sepse dikush ose disa nuk e duan vendosjen e drejtësisë, por duan t'i shmangen asaj për të ruajtur ekuilibrat e vjetër politikë, që, në fakt, ka ardhur koha të bien, dhe institucionet shtetërore t'i kthehen legjitimitetit.

Në këtë përpjekje të vështirë për të ngritur institucionet e larta të drejtësisë duhet të dalim përtej interesave personale, përtej partizmit dhe të dalim mode dhe me pjekuri duhet të legjitimojmë institucionet që i duhen shtetit dhe shoqërisë.

Kuptohet, në formatet që na vijnë proceset ka gabime dhe parregullsi, por ngritja e Gjykatës Kushtetuese dhe legjitimiteti i saj janë më të rëndësishme se parregullsitë teknike.

Institucionet kryesore politike të vendit, si Presidenti, Kuvendi, maxhoranca e majtë, si dhe

opozita duhet t'i lexojnë mirë mesazhet e ndërkombëtarëve, që e cilësojnë ngritjen e shpejtë të Gjykatës Kushtetuese si domosdoshmëri, aspekt që përkon me një nga kërkesat e Bundestagut gjerman. Kjo mund të ndikojë në proceset vlerësuese të institucioneve të BE-së për Shqipërinë dhe sidomos në mbledhjen e BE-së më 11 dhjetor 2019, si dhe do të përcjellë një mesazh në Forumin Ndërkombëtar të Sigurisë në Uashington më 12 dhjetor të vitit 2019, që Shqipëria është në drejtimin e duhur për sa i përket ngritjes së institucioneve të drejtësisë.

Ngritja e Gjykatës Kushtetuese është hapi i parë i rëndësishëm, për të vazhduar më tej me vetëqeverisjen dhe me çuarjen para drejtësisë të politikanëve të korruptuar; me realizimin e ekuilibrit institucional dhe me funksionimin e shtetit ligjor të pakompromisë me krimin, të gatshëm për të qenë në anën e historisë, duke pasur në krah aleatët tanë të mëdhenj.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Papa.

Fjalën e ka deputetja Elda Hoti.

Të përgatitet deputeti Kujtim Gjuzi.

Elda Hoti – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Kjo javë ka shënuar dy ngjarje të rëndësishme për Shqipërinë.

E para, beteja e zonës së Astirit, ku mijëra policë rrethuan 33 familje.

E dyta, krijimi i dy gjykatave paralele kushtetuese.

Kam përjetuar vetë raste të tilla në familjen time, prandaj sirena e ambulancës m'i shton rrahjet e zemrës dhe më bën t'ia hap me shpejtësi rrugën sa herë e shikoj. Shumë herë në këta muaj e kam parë të bllokuar në trafik. Jemi lodhur çdo ditë me të njëjtën situatë kaotike me trafik të rënduar. Jemi lodhur çdo ditë në stres. Jemi i vetmi kryeqytet pa unazë, sepse në çdo 4 vjet qeveritarët tanë duan të vjedhin. Në fund, kush humbet? Pa dyshim që populli.

Humbën 33 familje, që iu prishën shtëpitë dhe u luftuan si banda kriminale, ndërkohë që mund të negocionit dhe të arrinit një marrëveshje për dëmshpërblimin e tyre e jo t'i nxirrnit në mes të katër rrugëve.

Pse ish-deputetët, që i mbështetën për një vit dhe u bënë thirrje të gjithë shqiptarëve për protestë, ikën kur këta banorë kishin më shumë nevojë dhe i lanë vetëm? Kjo tregon se politika në Shqipëri është një gënjeshtëri e madhe. Po kush e pëson përsëri? Pa dyshim që vetëm populli shqiptar, i cili po merr çdo ditë e më shumë vetëm zhgënjime.

Tani ka plasur bomba tjetër, ashtu siç pushtuan me polici "Astirin", tani duan të pushtojnë Gjykatën Kushtetuese dhe sistemin e drejtësisë. Presidenti dekreton kandidaturat e tij dhe ato dublohen nga Kuvendi. Pra, kemi krijuar dy shtete paralele; ne kemi dy data zgjedhjesh; kemi dy parlamente, një në bulevard dhe tjetri në Kuvend; kemi gjysmë Gjykatë të Lartë; kemi dy pushtete lokale, një që nuk e lëshon karrigen dhe tjetri që ka ardhur me 15% të votave; ne kemi dy lista gjyqtarësh me emra anonimë. Po ku është elita e juristëve shqiptarë? Ku janë juristët e thinjur, që t'i vendosim në majat e sistemit të drejtësisë?

Të nderuar kolegë, neve nuk na duhen ushtarë në krye të Gjykatës Kushtetuese, por profesionistë dhe juristë të paanshëm. Nëse në krye të sistemit të drejtësisë vendosim familjarët e politikanëve tanë, atëherë duhet të jemi realistë se sistemi i drejtësisë nuk mund të jetë i paanshëm.

Krijimi i Gjykatës Kushtetuese ishte në krye të 9 kushteve të Bundesdagut. Ju lutem mos e poshtëroni kombin dhe veten! Populli shqiptar është mjaft i mprehtë për të kuptuar se ju nuk e doni reformën në drejtësi, nuk e doni Gjykatën Kushtetuese dhe as Gjykatën e Lartë të paanshme, ju nuk doni as hyrjen në Bashkimin Europian, sepse kështu qeverisni edhe 30 vjet pa ju kërkuar llogari askush.

Unë jam sot këtu, sepse unë nuk jam ushtar i askujt, t'ju them se shqiptarët nuk i nënshtrohen askujt. Ju po i lodhni çdo ditë e më shumë, saqë do të vijë dita që revolta e tyre ndaj jush do të çudisë botën.

Të tregojmë qytetari dhe atdhedashuri, mjaft me përplasje, të bëjmë hapa titanësh për një Shqipëri europiane.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Hoti!

Fjalën e ka deputeti Kujtim Gjuzi. Të përgatitet deputeti Artur Roshi.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, e nderuar zonja nënkryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë!

Faleminderit, kolegë dhe ju shkëlqesi ministra!

Sot kemi ardhur në një seancë jashtë radhe, e thashë edhe kur mora fjalën për procedurë. Konservatorët 3 vjet më parë kishin të drejtë kur thanë që Presidenti nuk duhet të jetë aty, por ju nuk e morët parasysh. Presidenti në detyrë, zoti Ilir Meta, do t'i thosha edhe Shkëlqesi, por nuk i them dot, në datën 08.06.2017 nga konservatorët është në Gjykatën Kushtetuese, prandaj ai nuk e do Gjykatën Kushtetuese. Po ju, a nuk keni përgjegjësi? Po, po, ju të maxhorancës keni përgjegjësi, sepse keni 24 mandate të intimiduara, 4 mandate këtu të rregulluara dhe ca tentativa të tjera. Nuk dua të nxjerr ndonjë sekret në lidhje me sekretarin e përgjithshëm të Partisë Socialiste, zotin Balla. Pra, duhet të shkarkojmë Presidentin e Republikës. Zoti Taulant, lëreni telefonin, përse nuk e mblidhni komisionin? Përse e mban peng Presidencën?

Presidentit të Republikës i kam thënë në stadiumin e Elbasanit jep dorëheqjen, po nuk e dhe dorëheqjen, është problem i madh. Shiko tani si të vjen vërdallë Kryeministri, i cili do të flasë tani 70 minuta. Shumë mirë, do ta dëgjojmë me vëmendjeje se ç'do të na thotë. Por Kryeministri ka një problem, sepse do të kapë Gjykatën Kushtetuese.

Dakord, ke kapur komitetet ekzekutive, që janë 60, por nuk të dalin. Gjithashtu, ke kapur të gjithë biznesmenët, sa një biznesmen nga Korça, i cili ka 700 milionë euro asete, tha: “Le të ikin shqiptarët, nuk ka problem, sepse do të vijnë disa të tjerë që të bëjnë turizëm këtu”. Unë i them këtij biznesmeni ta kesh të sigurt që do të shkosh përpara drejtësisë, megjithëse kam konflikt, sepse edhe unë vij nga biznesi, nuk mund të të lejoj ty të thuash që të ikin shqiptarët. Kush je ti që do të blesh shqiptarët, t'u blesh edhe biletat e avionit që të ikin? Këtu do të jemi. Këtu do të jenë konservatorët në parlament, mos kujtoni se kemi hyrë këtu kot, sepse ne e sollëm parlamentin në parametra. Sot nuk ka as bojë dhe as drogë, sepse këtu është futur edhe drogë.

Faleminderit, zonja nënkryetare!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Gjuzi!

Fjalën e ka deputeti Artur Roshi.

Artur Roshi – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Situata e emërimeve në Gjykatën Kushtetuese tregon përsëri se referenca e klasës politike është vetëm pushteti. Ashtu si ateistët, të cilët vetëm kur kanë probleme të vështira, kur u vihet jeta në rrezik, fillojnë të respektojnë Zotin, por nuk e besojnë atë, ashtu edhe politikanët shqiptarë, kur rrezikojnë pushtetin, i referohen Kushtetutës, por nuk e besojnë atë, sepse është e vetmja zgjedhje për të zgjidhur gjërat.

Kushtetuta pa konturet morale të krijuara nga doçet e traditës, mbështetur në parimet e të drejtës së individit në shoqëri, kthehet në një copë letër që mbledh abstragimet e çdokujt që kërkon t'i referohet. Meqenëse një traditë e tillë demokratike mungon, sapo na lind një mospërputhshmëri e tejkalueshme procedurale ligjore, na bën të kthehemi në pikën zero. Le t'i tejkalojmë këto mospërputhshmëri procedurale nëpërmjet një përputhshmërie politike të unifikuar në heshtje për një kohë të kufizuar deri sa të ngrihet tërësisht mekanizmi, që do të prodhojë reforma në drejtësi.

Gjendja e mosbesimit *biunivoque* (biunivok) mes qeverisë dhe Presidentit, krijoi idenë e kurtheve në mënyrë reciproke. Nga njëra anë qeveria mendoi se Presidenti donte të bllokonte apo ta vononte ngritjen e Gjykatës Kushtetuese për të cenuar negociatat, të cilat i shikon të njësuara me mbajtjen e pushtetit, nga ana tjetër, Presidenti mendoi se mosrespektimi i radhës President-Kuvend-Gjykatë e Lartë do ta çonte atë në një kurth nën emërimin “kushtetues”, për t'i rrëmbyer të drejtën legjitime të emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Kjo është e vërteta, që solli në këtë situatë.

Në fakt, Presidenti nuk ka mjete për ta zhblokuar këtë situatë. Ajo që zotëron të gjitha *attrezzatura*-t e mekanizmave procedurale në të gjitha institucionet është qeveria. Që të jemi racionalë duhet të pranojmë se përdorimi i të katra listave propozuese, me të njëjtët emra, nuk ka të bëjë fare me parimin e përzgjedhjes dhe me rregullin e propozimit të KED-së për tri kandidatura për një vend. Kështu si nisi, le të mbarojë.

KED-ja le të përpilojë dy lista të tjera, një për Presidentin dhe një tjetër për Kuvendin, në një prej të cilave mund të jetë sërish zonja

Vorpsi, sepse deklarata e saj noteriale nuk legjitimon asgjë, veç emocionit që ia uli arsyen për të respektuar betimin kushtetues. Le ta neglizhojmë veprimin e saj si një shaka kushtetuese. E them këtë, sepse zonja Vorpsi ishte e para në listë dhe, për pasojë, kishte probabilitet të lartë zgjedhjeje, por edhe për të ruajtur autoritetin e Kuvendit, që e zhvendosi emrin e saj, duke e marrë të mirëqenë zgjedhjen e saj.

Për sa i përket botimit në Fletoren Zyrtare, duhet futur në kornizën ligjore me një ligj të caktuar se në cilin rast mund të betohesh dhe kur jo, sepse herën e kaluar dekreti i Presidentit për anulimin e datës së zgjedhjeve u botua në Fletoren Zyrtare, por nuk prodhoi fuqi ligjore. Po tani pse duhet të prodhojë? Për sa i përket rezolutës, mendoj se nuk do të ketë ndonjë efekt përveç atij propagandistik.

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr zoti Ruçi.)

Gramoz Ruçi - Fjala për Kryeministrin, zotin Rama.

Edi Rama - Edhe një herë tjetër parlamenti është i detyruar të mblidhet në një seancë të jashtëzakonshme, për shkak të një historie tashmë të zakonshme me Ilir Metën. Edhe një herë tjetër, përplasja është jo midis nesh dhe Ilir Metës, por midis Ilir Metës dhe drejtësisë. Edhe një herë tjetër, për këdo që do të kuptojë, pa hyrë në të thella, jemi përballë, si Kuvendi i Shqipërisë, me njeriun që e ka humbur busullën dhe e ka kthyer institucionin e Presidentit të Republikës në një frëngji prej ku sulmon nga të katra anët, duke qenë në këtu 100%, jo 99%, por 100% në të njëjtën linjë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Europian.

Natyrisht, është e lehtë të kuptohet pse, si çdo herë tjetër, Ilir Meta nuk kursen as partnerët strategjikë dhe as dy aleatët e mëdhenj, të palëkundur dhe të pandryshueshëm të Shqipërisë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Europian, duke na vënë të gjithëve në një pozitë jokomode, për të thënë më të paktën dhe të turpshmen, për ta thënë me të gjitha fjalët deri në fund, sepse insinuan haptazi se këto përfaqësi të nderuara të shteteve, që janë qysh në ditën e parë të procesit të reformës në drejtësi promotore dhe mbështetëse të kësaj reforme, akuzohen si të korruptuara. Nuk ka më turp dhe, pas kësaj, besoj se nuk ka as nevojë të zgjatemi

dhe të stërzgjatemi për të shpjeguar arsyet që na sjellin këtu dhe drejtësinë e vendimmarrjeve tona.

Prandaj, këtë herë unë nuk do të merrem me Ilir Metën, por me drejtësinë që është ende në ardhje dhe që ende kërkon shumë vullnet, shumë durim dhe shumë mbështetje nga ana jonë. Për të gjithë ata që e ndjekin këtë episod të ri të historisë së vjetër të përplasjes së Ilir Metës me drejtësinë, dua të them se përpara se ne të vendosnim dhe të bënim atë që Kuvendi bëri, duke zgjedhur dy anëtarët e reja të Gjykatës Kushtetuese dhe duke marrë të mirëqenë zgjedhjen e një anëtareje tjetër si rezultat i mospërbushjes së detyrës për të zgjedhur në afatin e përcaktuar nga Presidenti i Republikës, ne jemi dakordësuar 100% me aleatët strategjikë dhe u jemi referuar 100% opinioneve të dhëna nga ekspertët e tyre, të cilët janë pjesë integrale e të gjithë procesit të reformës në drejtësi, ekspertët e EURALIUS-it dhe ekspertëve të OPDAT-it. Prandaj, për të gjithë njerëzit që duan të dinë të vërtetën e kësaj që po ndodh, kam një pyetje retorike: a është e mundur që Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Europian, si dhe ekspertiza e tyre t'i jenë vënë në dispozicion ndonjë projekti tjetër, përveç projektit të shpallur e legjitim të transformimit rrënjësor të drejtësisë shqiptare dhe të pavarësishtit përfundimtar të saj nga duart e politikës?! Besoj se për çdo mendje të arsyeshme përgjigja është e thjeshtë: kjo nuk është e mundur!

Sot ne jemi në pozitë të vështirë, edhe unë ndiehem në pozitë të vështirë, jo në raport me episodin, sepse episodi thjesht është një tjetër shprehje kuptimplote e të gjithë vështirësisë që ka kjo reformë qëkur ka nisur, por unë ndiehem në pozitë të vështirë në raport me njerëzit dhe pritshmëritë e tyre legjitime nga drejtësia që, siç e thashë dhe siç e dinë të gjithë, është ende në ardhje, por ende nuk është e prekshme, sepse nuk është aty për ta. Jo vetëm kaq, por sot, si rezultat i një numri të konsiderueshëm gjykatësish e prokurorësh, që i përkasin organizatës kriminale "kap ça të kapësh", "kçk", ajo që duhet të ishte drejtësi, është rëndom padrejtësi. Beteja jonë sot nuk është me Ilir Metën, por është me "kçk"-në. Ndërkohë, procesi për të cilin jemi mbledhur për të miratuar këtë rezolutë është shumë herë më i thjeshtë dhe krejtësisht i qartë. Ne bëjmë detyrën tonë sot karshi këtij institucioni dhe karshi

opinionit publik shqiptar, por nuk ka asnjë dyshim se kjo është një detyrë shumë e lehtë në raport me detyrën për të vepruar një orë e më parë kundër “kçk”-së, duke nxjerrë në pah të gjithë përmasën e llumit, që është kthyer në një shtupë, e cila e pengon sot, më shumë se asnjëherë tjetër, rrjedhjen e lirë të ujërave drejt konsolidimit të sistemit të drejtësisë.

Prandaj ky është një tjetër motiv për ne që të shpejtojmë dhe përshkallëzimin e luftës ndaj këk-së, të mos e lëmë thjesht dhe vetëm në radhën e pritjes së vetingut, por ta nisim dhe ta shoqërojmë njëkohësisht me një përshkallëzim të luftës kundër krimit të organizuar. Ata që kanë marrë dënime për krim të organizuar apo për krime të rënda të lidhura me veprimtari kriminale më shumë sesa një vrasje, ata që janë akuzuar për krim të organizuar dhe për krime të rënda të asaj natyre dhe që nuk janë dënuar si rezultat i atyre prokurorëve dhe atyre gjykatësve, që e kthyen drejtësinë në një pazar, ku kriminelët ishin të parët, të cilët jepnin ofertën, zakonisht kanë pasur ofertën më të mirë, si dhe ata që janë të hetuar për krim të organizuar jashtë vendit duhet të kthehen një orë e më parë në shënjestrën tonë. Nuk mundet më që ata nga njëra anë dhe këta të tjerët nga ana tjetër, “kçk”-ja, t’i gëzojnë pasuritë e tyre. Pikërisht ofensiva ndaj pasurive të tyre do të jetë thelbi i një procesi pa kthim, që do të duhet dhe do të nisë një orë e më parë.

Kam qenë këtu në këtë foltore, kur kam folur për rastin skandaloz të Durrësit dhe jam zotuar se do t’i sjell Kuvendit shumë shpejt një platformë ligjore për t’u miratuar dhe për t’u kthyer në një platformë lufte ndaj krimit të organizuar dhe “kçk-së”. Kjo nuk është çështje muajsh, por vetëm çështje e disa ditëve. Më 25 nëntor unë do t’ia prezantoj publikut shqiptar këtë platformë. Kjo platformë do të jetë sfida e vërtetë edhe e këtij Kuvendi, që do t’i ndajë edhe në këtë sallë ata që janë gati për ta shpallur këtë luftë me ata që nuk janë gati; do të ndajë njëherë e mirë një histori të vjetër, ku është përzier rëndom i njomi me të thatin dhe ku krimi i organizuar është kthyer nga një problem i përbashkët, në një motiv lufte politike, nga një armik i përbashkët, në një aleat politik të atyre që e kanë përdorur vijimësisht produktin e krimit për ta hedhur si mish të ngordhur në oborrin tonë. Kjo është koha kur i gjithë ky proces dhe i gjithë ky zinxhir krizash, i sajuar artificialisht

nga Ilir Meta dhe nga të gjithë ata që i përkasin frontit të mirënjohur qysh në ditën e parë kundër reformës në drejtësi, të marrin drejtimin e duhur dhe përgjigjen e duhur deri në fund nga ne. Kjo është koha kur përgjigja jonë duhet të jetë pa asnjë ekuivok dhe duhet të tundë themelet mbi të cilat, sot e gjithë ditën, qëndron ngrehina e krimit të organizuar në Shqipëri, duke tundur themelet e çdo pasurie të krimit dhe, po ashtu, duke tundur themelet nën këmbët e kujtdo që brenda sistemit të drejtësisë, prokuror apo gjykatës, është bashkuar me krimin.

Për sa i përket çështjes për të cilën jemi mbledhur, ajo që unë di është se asnjë kushtetutë, në asnjë vend demokratik, nuk mund të parashikojë se një vendi mund t’i bjerë taksirati të ketë një President si Ilir Meta. E për këtë arsye, ky Kuvend duhet të marrë masa ligjore kushtetuese për të krijuar të gjithë mekanizmat zhblllokues ndaj çdo akti flagrant dhe brutal bllokimi të atij, që zyrën e Presidentit e ka kthyer në një frëngji për të shantazhuar parlamentin, për të shantazhuar ndërkombëtarët dhe për të shantazhuar popullin shqiptar.

Besoj se komisioni *ad hoc*, i ngritur për shkarkimin e Ilir Metës, duhet ta konsiderojë shumë seriozisht edhe paketën e rekomandimeve për Kuvendin, ashtu sikundër në dritën e kësaj ngjarjeje të re, Komisioni i Ligjeve dhe të gjithë deputetët duhet të kontribuojnë për të riadur këtu në Kuvend, më shpejt se vonë, për të votuar këtu neutralizimin e akteve të Presidentit, të akteve antikushtetuese dhe antiligjore.

Është shumë e thjeshtë, merreni me mend, kemi bërë një reformë drejtësie për të hequr interesat e politikës dhe pazaret e politikës nga procesi i emërimeve. Kemi ngritur një institucion të posaçëm të pavarur, Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, i cili është institucioni i vetëm që ka detyrimin, përveçse të drejtën, të udhëheqë procesin dhe t’i vendosë përpara Presidentit dhe Kuvendit listat e kandidaturave, sipas mekanizmave të mirëpërcaktuar dhe sipas radhës për të zgjedhur. Nuk ka interpretime të mundshme në këtë proces, nuk ka zyra ligjore as në Presidencë, as në Kuvend dhe as në Kryeministri që mund të bëjnë interpretime dhe mund të thonë se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi e ka gabim. Është njësoj si të mblidhet Kuvendi këtu dhe të bëjë një interpretim se Gjykata Kushtetuese e ka gabim, apo të mblidhet

qeveria dhe të bëjë një interpretim se një gjykatë ka vendosur gabim.

Natyrisht, gjithkush ka të drejtë të bëjë interpretime politike dhe të bëjë interpretime mediatike, por nuk ka askush të drejtë që interpretimet t'i kthejë në instrument për të kundërsulmuar dhe jo vetëm kundërsulmuar, por edhe për të mos iu bindur institucioneve të pavarura të drejtësisë. Është shumë e thjeshtë. Të gjitha diskutimet e tjera janë “dokrra hini”, kur thoshte At Gjergj Fishta. Kush jemi ne, kush është ky President (se kush janë këta të tjerët që bëjnë komente nëpër studio dhe nëpër portale, as nuk ia vlen fare ta ngresh pyetjen), që të mund të interpretojmë dhe të mund të vendosim ndryshe nga çfarë kanë vendosur institucionet e drejtësisë dhe, në rastin konkret, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi? Kështu që nuk ia vlen të humbasim më shumë kohë për të analizuar, për të argumentuar dhe për të komentuar marrëzitë e Ilir Metës.

Na ka rënë ky taksirat neve, u ka rënë ky taksirat shqiptarëve dhe do të bashkëjetojmë me këtë taksirat, për aq kohë sa zyra e Presidentit të Republikës do të jetë “tokë e xanun” nga dikush që ka humbur busullën. Nga ana tjetër, ne jemi të detyruar të ndjekim vijën e drejtë që kemi përcaktuar së bashku me aleatët tanë strategjikë dhe, për sa kohë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian, zyrtarisht, publikisht, kanë mbështetur çdo lëvizje që ne kemi bërë, kushdo që do të kuptojë, kupton që ne në këtë proces as jemi vetëm dhe as marrim përsipër që të vetëm të bëjmë reagimet tona. Reagimet tona janë të gjitha të koordinuara, pasi kemi dëgjuar dhe dëgjojmë me shumë vëmendje ata me të cilët e kemi bërë reformën në drejtësi dhe me ata të cilët do ta zbatojnë reformën në drejtësi. Kjo është edhe arsyeja pse edhe për ligjin special kundër krimit të organizuar dhe “kçk-së” ne jemi në një proces intensiv diskutimi dhe koordinimi me ta, pasi do të jetë një luftë që nuk është parë ndonjëherë në Shqipëri dhe do të jetë një luftë ku kemi nevojë, pa diskutim, për mbështetjen e tyre; jo thjesht mbështetje juridike, por mbështetje të gjithanshme.

Në këto kushte, të votojmë rezolutën dhe të vazhdojmë pa e humbur fokusin nga detyrat dhe detyrimet tona.

Nuk kemi ne luftë me Ilir Metën. Ky i fundit ka luftë me botën, me Europën, me

Shqipërinë, me qeverinë dhe me veten. Le të vazhdojë ta bëjë atë luftë, ndërkohë ne kemi detyrën të shmangim të gjitha efektet negative që aktet e asaj lufte kanë mbi proceset tona: proceset zgjedhore, proceset e formimit të institucioneve të drejtësisë dhe mbi çdo proces tjetër, ku ky njeri ka marrë përsipër të jetë interpretuesi i vetëm dhe fuqiplotë i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, njësoj si ata talebanët, të cilët e quajnë veten interpretuesit e vetëm dhe fuqiplotë të librit të shenjtë!

Faleminderit!

(Duartrokitje nga salla)

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Rama!

Këtu mbyllet debati për projektrezolutën.

Jemi gati për votim?

Hapet votimi për prezencën.

Të hiqen kartat e deputetëve që nuk janë prezentë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Beqaj, jeni këtu? Pse nuk votoni për prezencën?

Mbyllet votimi për prezencën.

102 deputetë janë prezentë.

Projektrezoluta “Shmangia e krizës kushtetuese me synim legjitimitetin e Gjykatës Kushtetuese – detyrë imperative e organeve më të larta të shtetit”.

Para se të kalojmë në procedurën e votimit, ju rikujtoj se do të votohet për draftin e rishikuar nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, të cilin e keni para në tavolinë. Procedura e votimit është një votim i hapur me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Me 97 vota pro, asnjë votë kundër, katër vota abstenim dhe dy deputetë nuk morën pjesë në votim, miratohet projektrezoluta.

(Duartrokitje nga salla)

Vazhdojmë me votimin e projektvendimit “Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të posaçëm parlamentar për realizimin e Reformës Zgjedhore”. Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, ky projektvendim kërkon shumicë të thjeshtë votash.

Me propozim të Komisionit të posaçëm parlamentar për realizimin e Reformës Zgjedhore, afati i veprimtarisë së këtij komisioni zgjatet për një periudhë tremujore nga data e miratimit të këtij projektvendimi.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 15 NËNTOR 2019

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Me 104 vota pro, asnjë votë kundër, asnjë votë abstenim miratohet zgjatja e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore.

Këtu mbyllet axhenda e ditës së sotme.

Seanca tjetër do të njoftohet.

Faleminderit!

(Seanca u mbyll në orën 11:40)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

Drejtori i Shërbimit të Botimeve

Parlamentare

Krenar Hajdëri

